



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Datë :	02.06.2026
Referencë	11-344/5
Për :	Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës
Kopje:	Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës
Nga:	Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit
Lënda :	Raporti i muajit-maj

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Gjatë muajit maj Drejtoria e Inspektoratit ka ndjekur agjendat e caktuara sipas planifikimeve dhe ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë.

Inspektori i mjedisit-ambientit- Janë shqyrtuar ankesat e pranuar nga qytetaret, ankesat ishin në fshatrat Kleçkë, Shalë, ndotje me ujëra të zeza, pastaj në fshatin Sllovi ankesë për zhurmë dhe aroma të pakëndshme si pasojë e vendosjes së ventilatorit nga një biznes afër shtëpisë së ankuesit, ankesë në qytet dhe fshatin Grack e Vjetër për mbeturina inerte dhe tjera të lëna në hapësirë publike. Për rastet në fjalë janë dhënë urdhëresat që të sanohen parregullsitë e konstatuara brenda një afati të caktuar, në të kundërtën do të pasojnë masat ligjore.

Janë bërë inspektime në deponi ilegale të mbeturinave në f.sh Gadime, Sllovi, Krojmir, lagja Pojata, kodrën e Kërçevës etj. Për të marrë veprime ligjore ndaj atyre që takohen apo gjinden dëshmi për hedhje të mbeturinave, ndotje të mjedisit.

Është inspektuar objekti që ka filluar të ndërtohet në Rr. “Fehmi Agani”, në lidhje me zbatimin e kushteve të LMK-së. Investitori është urdhëruar që vendpunishtja të jetë pa mbeturina, ato të dorëzohen K. Pastrimi.

Është bërë rikontrollë tek bizneset në qytet që kanë aplikuar për shfrytëzim të hapësirës publike që ti kryen pagesat dhe të pajisen me pëlqim.

Një biznese i cili ushtron veprimtarinë e eksploatimit të gurit gëlqeror në fshatin Sllovi ju është ndaluar eksploatimi i gurit deri sa të pajiset me dokumentacion përkatës nga MMPH. Operatori ka zbatuar urdhëresën menjëherë, ka ndërprerë punimet.

Inspektorët e trafikut- Gjatë muajit maj janë realizuar inspektime të firmave të autobusëve, auto-taksive, radio taksive. Gjatë këtyre inspektimeve është kontrolluar respektimi i rendit të udhëtimit dhe posedimi i certifikatave të autobusëve, duke urdhëruar respektimin e rendit të udhëtimit sipas dispozitave dhe autorizimeve të lëshuara nga organi kompetent.

Janë kryer gjithashtu inspektime në fshatin Suhodoll lidhur me qarkullimin e kamionëve të firmës ku është kërkuar respektimi i kufizimit të peshës së ngarkesës për të parandaluar dëmtimin e rrugëve. Në Janjevë është trajtuar një ankesë lidhur me vendosjen e shtyllave elektrike, ku është konstatuar gjendja në terren dhe janë dhënë udhëzimet e nevojshme për palët përgjegjëse.

Gjithashtu janë realizuar kontrollat të vazhdueshme në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” për verifikimin e operatorëve taksit, ku është bërë inspektimi i radio-taksive që marrin pasagjer pa porosi dhe auto-taksit ilegal. Janë inspektuar disa kompani të radio-taksit të cilët kishin licenc dhe merrnin udhëtar vetëm me porosi, Po ashtu janë kryer kontroll në rrugën Shën Flori lidhur me ndotjen e rrugës nga kamionët e angazhuara në punime ndërtimore, me ç’ rast është urdhëruar pastrimi i menjëhershëm dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e pastërtisë.

Inspektori i ndërtimit-. Përgjatë muajit maj inspektori i ndërtimtarisë ka inspektuar objekte të ndryshme ndërtimi në teren, e sidomos përgjatë zonës urbanistike, industriale, ekonomike. Me procesverbal është evidentua dhe konstatuar për të gjitha ndërtimet me leje ndërtimi dhe ato pa leje ndërtimi. Ndaj ndërtimeve pa leje janë ndërmarrë masa ligjore, duke vendosur edhe shirita zyrtar.

Drejtoria e Inspektoratit është përgjigjur në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit maj janë:

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Vendosje të shiritave zyrtar.

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët																				
Gjithsej inspekte																				
Inspekte me procesverbal																				
Objekte të legalizuara																				
Fletëparaqitje																				
Njoftime nga DPMUMM-ja																				
Njoftime																				
Vërejtje																				
Pranim teknik me komision (projekte komunale)																				
Vendosje të shiritave																				
Inspekte me miratim																				
Punë me palë, ankesa , kërkesa																				
Lendet e pranuara																				
Lende te pezulluara, ekzekutuara gjyqësore																				
Inspekte në ANP																				
Gjoba mandatore																				
Njoftim për fillimin e ndërtimeve																				
Leje ndërtimore																				
Menaxhim i tregjeve																				
Aktivendime, ndalesa, urdhëresa																				
Inspekte për leje Mjedisore Komunale																				
Inspektim me polici																				
Inspekte të përbashkëta																				
Ambienti	23	6				3				5	8							1		
Ndërtimi	58	17	1	1		7		1		6	21			1		1		2		
Trafiku	94	9					13		28		4		23			7			2	8
Gjithsej	175	32	1	1		10	13	1	28	11	33		23	1		1	7	2	1	8

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

TAKIME TË TJERA

Takimet kryesisht janë mbajtur me qytetarë.

SFIDAT

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese.

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.